STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për njoftim të menjëhershëm: 4 nëntor 2012

GUVERNATORI CUOMO NJOFTON PEZULLIMIN E TAKSËS RRUGORE (TOLL) NË URAT MTA TË ROCKAWAYS

Taksa rrugore në urat e Marine Parkway dhe Cross Bay pezullohet

Humbja e një treni i la banorët e Rockaways pa një alternativë tranziti

Guvernatori Andrew M. Cuomo njoftoi sot pezullimin e taksës rrugore për urën Marine Parkway – Gil Hodges Memorial Bridge dhe urën Cross Bay Veterans Memorial Bridge drejt Rockaways, me prapaveprim që në momentin që urat u rihapën pas stuhisë.

"Populli i Rockaways vuajti jashtëzakonisht nga uragani Sandy, dhe me humbjen e shërbimit të trenit A, nuk ka mënyrë të lehtë për shumë prej tyre për të lëvizur vajtje-ardhje në pjesën tjetër të Nju Jorkut", tha guvernatori Cuomo. "Ne po marrim masa për të pezulluar këto taksa rrugore për ta bërë më të lehtë rimëkëmbjen si për banorët e Rockaways ashtu dhe njerëzit që i ndihmojnë ata".

Taksa rrugore (toll) prej 3,25 dollarë kesh dhe 1,80 dollarë për taksën E-ZPass për makinat në të dyja urat do të pezullohet menjëherë sonte, tha kryetari dhe drejtori ekzekutiv i MTA (Metropolitan Transit Authority) Joseph J. Lhota. Taksat E-ZPass që u paguan me rihapjen e urave do tu kthehen klientëve me prapa veprim në llogaritë e tyre. Pezullimi do të vazhdojë deri në fund të nëntorit gjatë kohës që do të vazhdojnë përpjekjet e rimëkëmbjes.

Ura Marine Parkway – Gil Hodges Memorial Bridge u mbyll përpara uraganit Sandy në orën 6:58 pasdite të ditës së hënë, më 29 tetor dhe u rihap në orën 4:45 pasdite të ditës së martë, 30 tetor. Ura e Cross Bay Veterans Memorial Bridge u mbyll përpara uraganit Sandy në orën 4:30 pasditen e ditës së hënë, më 29 tetor dhe u rihap në orën 1:30 të pasdites ditën e mërkurë më 31 tetor.

Të dyja urat operohen nga autoriteti Triborough Bridge dhe Tunnel Authority (TBTA), njësia e MTA që njihet zakonisht si MTA Bridges and Tunnels. Sipas Ligjit të Autoriteteve Publike shtetërore (Public Authorities Law) dhe kontratave me poseduesit e obligacioneve TBTA, MTA duhet që ligjërisht të vendosë taksa rrugore për të gjithë përdoruesit e urave me përjashtime shumë të rralla.

Guvernatori Cuomo u konsultua me liderin e shumicës së Senatit Skelos dhe me kryetarin Sheldon Silver të cilët u shprehën më një mendje për plotësimin e kërkesave ligjore të MTA.

Lideri i shumicës në Senat Dean Skelos tha, "Është krejtësisht me vend që të pezullojmë taksat rrugore në urat që çojnë në Rockaways me qëllim që banorët dhe punonjësit e rimëkëmbjes të

Albanian

kenë akses më të lirë për të hyrë e dalë nga zona e cila u shkatërrua kaq rëndë nga stuhia”.

Kryetari i Asamblesë Sheldon Silver tha, “Heqja e taksës së rrugës për urat është një hap kuptimplotë që ndihmon në lehtësimin e barrës së qytetarëve të Rockaways pas shkatërrimeve të uraganit Sandy. Ne kemi kënaqësinë të punojmë me guvernatorin i cili ka demonstruar një udhëheqje të jashtëzakonshme gjatë gjithë krizës, për të ndihmuar komunitetet tona që janë shkatërruar nga kjo stuhi e tmerrshme”.

###

Lajme të tjera do t'i gjeni në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418